



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të nenit 11 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 17 Nëntor 2022,
Bordi i Federatës miraton këtë:

RREGULLORE NR. #05

PËR

**GARAT E FEDERATËS
DHE RREGULLAT PËRKATËSE**

VERSIONI 1.2



PËRMBAJTJA

PËRKUFIZIMET	2
1. Qëllimi dhe fushëveprimi.....	3
2. Vlefshmëria e Rregullave të Tenisit.....	3
3. Sezoni dhe kalendari	3
4. E drejta për pjesëmarrje	4
5. Grupmoshat dhe kufijtë përkatës	4
6. Rregullat e përgjithshme të pjesëmarrjes dhe organizimit	5
7. Garat e Federatës.....	7
8. Sistemi i garave.....	8
9. Dimensionet e fushës dhe rekuizitat	9
10. Afatet për paraqitje dhe hedhjen e shortit	9
11. Formati i turneve “ROG” të Kampionatit të Kosovës në Tenis	10
12. Formati i turneve “Junior” dhe “A” të Kampionatit të Kosovës në Tenis	12
13. Formati i turneve “Veteran” të Kampionatit të Kosovës në Tenis	15
14. Kupa e Kosovës në Tenis	17
15. Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor	19
16. Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës.....	22
17. Kampionati i Tenisit në Rërë dhe mbi Karroca.....	22
18. Pushimet, nxehjet dhe afatet	23
19. Kërkesat e përgjithshme infrastrukturore për organizimin e garave dhe turneve.....	24
20. Kërkesat për topa	25
21. Obligimet e Organizatorit	26
22. Pikëzimet / Ranglistat	27
23. Kërkesat për Mbikëqyrës e gjyqtarë	27
24. Obligimet e Mbikëqyrësit dhe gjyqtarëve.....	28
25. Shpërblimet	29
26. Rregullorja Disiplinore.....	30
26.5. Kodi i sjelljes	30
27. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera.....	33



VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	28.12.2020	Bordi/28.12.2020	-
1.1	28.09.2021	Bordi/28.09.2021	<p>15.5. Ekipi pjesëmarrës në Kupën e Kosovës në Tennis Ekipor duhet të ketë minimum dy (2) lojtarë dhe maksimumi katër (4) lojtarë për kategorinë meshkuj, e njëjta vlen edhe për kategorinë femra. Vetëm ekipet të cilat kualifikohen në finale kanë të drejtë përfshirjen e një lojtari mysafirë (nga jashtë Kosovës) në ekip vetëm për ndeshjen finale, në xhirot paraprake pranohen vetëm tenistët vendas.</p> <p>15.7 Bartësit në shortin e Kupës së Kosovës në Tennis Ekipor përcaktohen së pari sipas ranglistës për kategori përkatëse – hiqet</p> <p>15.9. Shpenzimet e udhëtimit dhe të ushqimit, si dhe të qëndrimit (në rast se fjetja bëhet në mënyrë të organizuar nga federata) për të gjitha ekipet do t'i bartë federata.</p> <p>15.10. Fitues i përgjithshëm i një përballjeje në mes të dy ekipeve është ekipi që arrin t'i fitojë së paku dy (2) meçe për garat e meshkujve, e njëjta vlen edhe për garat e femrave.</p> <p>15.11. Fillimisht luhen dy (2) meçe individuale me format standard me dy (2) seta të fituar, pasuar nga një (1) meç në çiftë me format me dy (2) seta të fituar ku seti i tretë është set i plotë.</p> <p>15.12. Kërkesat minimale për topa të ri janë: së paku tre (3) topa në fillim të setit të parë, ndërrimi i parë i topave pas gejmës të nëntë (9), pastaj ndërrimet e radhës pas çdo njëmbëdhjetë (11) gejmës.</p> <p>15.13. Çdo ekip do ta ketë kapitenin e ekipit, i cili do t'i emërojë lojtarët e meçeve individuale pesëmbëdhjetë (15) minuta para fillimit të meçit të parë. Në meçin e parë, lojtari i dytë (i ranguar më lartë) i njërit ekip, ndeshet me lojtarin e dytë (i ranguar më lartë) të ekipit tjetër. Në meçin e dytë, lojtari i parë (i ranguar më lartë) i njërit ekip ndeshet me lojtarin e parë (i ranguar më lartë) të ekipit tjetër. Për të siguruar renditjen të saktë përgjegjës është Mbikëqyrësi / gjyqtari i karriges i përballjes. Kur lojtarë nuk janë të ranguar, kapiteni përcakton renditjen e lojtarëve.</p>
1.2	24.03.2022	Bordi/ 23.03.2022	<p>11.6.Mbikëqyrësi i turneut 'ROG' duhet të ndërprej ose të anulojë turnun në rast se arrihen temperaturat ekstreme. Temperatura minimale është 10 gradë Celcius, ndërsa temperatura maksimale 32 gradë Celcius.</p> <p>a) Garat mbahen me short të eliminimit nga xhiro R64 deri në Finale, me përjashtim turnet e grupmoshës U12. Nëse në një turne janë paraqitur 6 e më pak lojtarë, turneu mund të mbahet me short Round-Robin, ndërsa nëse janë 7 e më shumë lojtarë turneu mbahet me short të eliminimit. Format i mbajtjes së turneut përcaktohet në bashkëpunim me organizatorin e turneut dhe mbikëqyrësinë duke u bazuar në kushtet infrastrukturore me qëllim që turneu të përfundojë me sukses.</p> <p>12.8. Mbikëqyrësi i turneut duhet të ndërprej ose të anulojë turneun në rast se arrihen temperaturat ekstreme. Temperatura minimale është 10 gradë Celcius, ndërsa temperatura maksimale 35 gradë Celcius.</p> <p>15.5. Ekipi ka të drejtë përfshirjen e lojtarëve mysafirë (nga jashtë Kosovës) në ekip me numër të pakufizuar, këta lojtarë duhet të paraqiten bashkë me pjesën tjetër të ekipit sipas afateve të parapara me paragrafin 10.2 të kësaj Rregullore.</p> <p>16.7. a) Lojtari që i pari fiton dhjetë (10) pikë, e fiton setin dhe lojën. Në finale, duhet fituar dy seta deri në dhjetë (10) pikë, kur rezultati është 9-9 luhet pika vendimtare e cila përcakton fituesin.</p>



PËRKUFIZIMET

<i>Administrata</i>	Administrata e Federatës me të cilën udhëheq Sekretari
<i>ATP</i>	Shoqata e Tenistëve Profesionistë
<i>Bordi</i>	Bordi Ekzekutiv i Federatës
<i>TE ose Tennis Europe</i>	Federata Evropiane e Tenisit
<i>FTK ose Federata</i>	Federata e Tenisit e Kosovës
<i>Gara</i>	Një turne i llojit të caktuar
<i>ITF</i>	Federata Ndërkombëtare e Tenisit
<i>Klubi</i>	Klub i Tenisit, anëtar i Federatës
<i>Komisari</i>	Komisioni i garave, ose në mungesë të tij, Komisari i garave
<i>KRTK</i>	Këshilli i Referëve të Tenisit të Kosovës
<i>Mbikëqyrës</i>	Gjyqtar i Federatës, anëtar i KRTK, i licencuar si Mbikëqyrës
<i>Organizatori</i>	Organizatori i turneut
<i>RR</i>	Round-Robin, lojë në grup ku secili luan kundërsecilit
<i>Rregullat e Tenisit</i>	Rregullat e Tenisit, Tenisit mbi Karroca, të ITF-së
<i>Sekretari</i>	Sekretari i Përgjithshëm i Federatës
<i>STB(x)</i>	Set përcaktues i meçit (Super Tie-Break) deri në x pikë
<i>TB(x)</i>	Gem përcaktues i setit (Tie-Break) deri në x pikë
<i>WTA</i>	Shoqata e Tenisit të Femrave

Fjalët “tenist”, “anëtar”, “ai” dhe të ngjashme, të cilat flasin për personin në gjininë mashkullore, përveç kur kanë të bëjnë me ngjarje ose raste të ndara gjinore, përfshijnë edhe gjininë femërore.



1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e garave zyrtare të tenisit të organizuara në territorin e Republikës së Kosovës nën ombrellën e Federatës së Tenisit të Kosovës.
- 1.2. Përmes kësaj rregullore synohet të ketë edhe përmirësim në organizimin e garave, dhe ngritje të profesionalizmit të gjithmbarshëm.

1 Vlefshmëria e Rregullave të Tenisit

- 2.1. Kjo rregullore vlen për çështjet të cilat trajtohen në mënyrë specifike në këtë rregullore, ndërkaq në të gjitha rastet e tjera do të vlejnjë Rregullat e Tenisit përkatëse.
- 2.2. Rregullat e Tenisit të përditësuara gjenden në uebfaqen e ITF-së. Versioni në gjuhën shqipe gjendet në uebfaqen e Federatës.

1 Sezoni dhe kalendari

- 3.1. Periudha e mbajtjes së garave për një vit të caktuar (Sezoni) mbahet në mes të muajve janar dhe nëntor. Garat përmbyllen në nëntor, kur edhe mbahen me garat për Kupën e Kosovës në Tenis (turnetë “*Masters Finals*”). Muaji dhjetor është pushim.
- 3.2. Kalendari i turneve, për garat që mbahen, shpallet në Kalendarin Zyrtar të Federatës. Në fillim mund të shpallet vetëm kalendari dimëror, që mbulon tremujorin janar-mars, pasuar nga kalendari i plotë i cili e përfshinë të gjithë sezonin (janar-nëntor).
- 3.3. Përgjegjës për hartimin e kalendarit është Komisarari. Ai këtë e bën në bashkëpunim me klubet, dhe varësisht objektivave dhe vendimeve të Bordit për atë sezon. Përparësi do të kenë turnet që janë mbajtur sistematikisht ndër vite.
- 3.4. Pranimi i një turneu në kalendarin zyrtar është në diskrecionin e Komisararit.



E drejta për pjesëmarrje

- 4.1. Të drejtë për pjesëmarrje në turnetë e tenisit kanë të gjithë shtetasit e Kosovës, pa diskriminim, përderisa plotësojnë kushtet e moshës, gjinisë, dhe normës së pikëve të nevojshme, të parapara me rregullat e turneve përkatëse.
- 4.2. Të drejtë për pjesëmarrje në turnetë e hapur kanë edhe shtetasit e huaj. Nëse një shtetas i huaj dëshiron të jenë pjesë e ranglistës së Federatës, i njëjti duhet të anëtarësohet në Federatë sikurse të gjithë tenistët shtetas të Kosovës.
- 4.3. Në turnetë e Kupës së Kosovës në Tenis Ekipor, gjatë një sezoni të caktuar ekipi (klubi) mund të paraqesë me numër të pakufizuar tenistë me shtetësi të huaj.
- 4.4. Në turnetë përmbyllës të vitit Masters, nuk mund të marrin pjesë shtetasit e huaj.

Grupmoshat dhe kufijtë përkatës

- 5.1. Moshat e lejuara për pjesëmarrje në një grupmoshë të caktuar janë:

Grupmosha	Përshkrimi	Kufiri i poshtëm	Kufiri i epërm	Grupimi
08-	8 vjeç e më pak	≥ 5 vjeçar në <i>FT</i>	≤ 8 vjeçar në <i>PV</i>	ROG Kuq
09-10	10 vjeç e më pak	≥ 7 vjeçar në <i>FT</i>	≤ 10 vjeçar në <i>PV</i>	ROG Portokall
10-11	11 vjeç e më pak	≥ 8 vjeçar në <i>FT</i>	≤ 11 vjeçar në <i>PV</i>	ROG Gjelbër
12-	12 vjeç e më pak	≥ 9 vjeçar në <i>FV</i>	≤ 12 vjeçar në <i>PV</i>	Junior
14-	14 vjeç e më pak	≥ 11 vjeçar në <i>FV</i>	≤ 14 vjeçar në <i>PV</i>	Junior
16-	16 vjeç e më pak	≥ 12 vjeçar në <i>FV</i>	≤ 16 vjeçar në <i>PV</i>	Junior
18-	18 vjeç e më pak	≥ 13 vjeçar në <i>FV</i>	≤ 18 vjeçar në <i>PV</i>	Junior
AD	Mosha madhore	≥ 14 vjeçar në <i>FT</i>	-	A
35+	35 vjeç e më shumë	≥ 35 vjeçar në <i>FT</i>	-	Veteran
55+	55 vjeç e më shumë	≥ 55 vjeçar në <i>FT</i>	-	Veteran

- 5.2. Për qëllime të paragrafit 5.1 sipër, shkurtesat *FT*, *FV*, *PT*, dhe *PV* kanë këto kuptime:
 - a) *FT* – Data e fillimit të turneut;
 - b) *FV* – Data e fillimit të vitit kalendarik;
 - c) *PT* – Data e përfundimit të turneut; dhe
 - d) *PV* – Data e përfundimit të vitit kalendarik.



Rregullat e përgjithshme të pjesëmarrjes dhe organizimit

- 6.1. Tenisti duhet të paguajë anëtarësinë vjetore në Federatë, përpara se të mund të merr pjesë në cilindo turne të atij viti. Tarifa për anëtarësi vjetore përcaktohet me [Rregulloren #02](#) të Federatës për Tarifat.
- 6.2. Për pjesëmarrje në një turne të caktuar, tenisti duhet t'i paguajë organizatorit tarifën për pjesëmarrje në turne, në përputhje me [Rregulloren #02](#) të Federatës për Tarifat.
- 6.3. Tenisti që merr pjesë në gara duhet ta ripërtërijë certifikatën mjekësore së paku çdo dymbëdhjetë (12) muaj. Është obligim i Mbikëqyrësit të mos e lejojë tenistin të merr pjesë në turne, nëse i njëjti e ka certifikatën mjekësore të skaduar.
- 6.4. Një tenist nuk mund të merr pjesë në të njëjtën kohë në dy turne të ndryshëm, ose në dy grupmosha të ndryshme të të njëjtit turne që mbahen në kohë të njëjtë.
- 6.5. Në ROG tenistët nuk mund të luajnë në dy grupmosha brenda një viti kalendarik. Nëse tenisti gjatë vitit kalendarik kalon në grupmoshë më të lartë atëherë i njëjti nuk mund të kthehet në grup moshën paraprake më të ulët.
- 6.6. Organizator i një turne zyrtar të Federatës mund të jetë klubi, njëperson privat apo juridik, apo edhe vetë Federata. Tarifa e aplikimit për të mbajtur një turne, nëse ka, publikohet në [Rregulloren #02](#) të Federatës për Tarifat, dhe duhet paguar me rastin e parashtrimit të kërkesës.
- 6.7. Çdo klub anëtar i Federatës, duhet të organizojë së paku një turne zyrtar ose ngjare tjetër të tenisit gjatë një viti kalendarik, në mënyrë që të përfitojë nga mbështetja e Federatës.
- 6.8. Për t'u mbajtur një turne zyrtar, Mbikëqyrësi duhet të jetë i deleguar nga KRTK. Kërkesat minimale për gjyqtarë të karriges dhe vijave për një lloj të turneut, nëse ka, parashihen veçanërisht tek pjesa që flet për atë lloj të turneut.
- 6.9. Turneu duhet të shpallet në kalendarin zyrtar të garave, dhe në portal së bashku me informacionet kyçe, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së fillimit të turneut.
- 6.10. Një turne i grupmoshës së caktuar, duhet të organizuar edhe për gjininë mashkullore edhe për atë femërore. Klubet inkurajohen të njëjtën të e aplikojnë edhe për grupmoshën Adult. E njëjta nuk vlen për grupmoshën "Veteran", e as për grupmoshat ku nuk janë së paku katër (4) tenistë të regjistruar të asaj gjinie.



- 6.11. Organizatori është i obliguar ta mbajë turneun në terminin e paraparë në kalendar, dhe mund ta anulojë atë vetëm pas paralajmërimit prej së paku tridhjetë (30) ditë para fillimit të turneut. Pas këtij afati, çdo anulim i turneut nga organizatori gjobitet me pesëdhjetë euro (50€).
- 6.12. Është përgjegjësi e Mbikëqyrësit i cili në dakordim me organizatorin mund ta anulojë turneun në rast se, numri i pjesëmarrësve është shumë i vogël, ose kushtet atmosferike nuk e lejojnë mbajtjen e turneut.
- 6.13. Organizatori duhet t'i plotësojë kriteret dhe kushtet minimale të parapara me këtë Rregullore, në mënyrë që ta organizojë një turne zyrtar. Në këtë drejtim, ai bashkëvepron me Komisararin dhe Mbikëqyrësin për t'i përmbushur kërkesat.
- 6.14. Organizatori është përgjegjës për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet e një turneu zyrtar. Në rast se Federata merr përsipër mbulimin e plotë ose të pjesshëm të ndonjë shpenzimi, lloji i shpenzimit dhe niveli i mbulimit përcaktohen me [Rregulloren #03](#) të Federatës për Financat.
- 6.15. Në rast se një turne që ka nisur, nuk arrin të përfundojë deri në ditën e fundit të paraparë, ndeshjet e mbetura mund të shtyhen më së largu për dy ditë. Në rast se, për shkak të motit, ndeshjet nuk mund të luhen as në dy ditët e ardhshme, tenistëve iu llogariten vetëm arritjet e deriatëhershme në turne. Megjithatë, tenisti që në ditën shtesë nuk paraqitet për ndeshje, e humb ndeshjen pa lojë.



1 Garat e Federatës

7.1. Garat që mbahen çdo vit në kuadër të Federatës janë:

- Kampionati i Tenisit i Kosovës
- Turnetë përmbyllës të vitit "Masters Finals")
- Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor
- Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës

7.2. Garat që mbahen varësisht interesimit dhe mundësive, me vendim të Bordit në fillim të çdo viti, janë:

- Kampionati i Tenisit në Rërë i Kosovës
- Kampionati i Tenisit mbi Karroca i Kosovës

7.3. Kategoritë në të cilat mbahen garat varen nga konkurrenca, si dhe gjinia e grupmosha e tenisit. Për garat e Federatës, kategoritë janë:

Gara	Gjinitë	Konkurrenca	Grupmoshat
Kampionati i Tenisit i Kosovës	M F	S D	08-55
Turnetë përmbyllës 'Masters Finals'	M F	S	12-AD
Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor	M F X	X	AD
Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës	X	S	1 grupim: Të gjithë
Kampionati i Tenisit në Rërë i Kosovës	X	D	2 grupime: 10-14 dhe 16-55
Kampionati i Tenisit mbi Karroca i Kosovës	M F	S D	1 grupim: 16-55

7.4. Kategoritë shënohen me një kod katër shifror të përbërë nga:

- Shifra 1: Gjinia (M-Meshkujt, F-Femrat, X-Përzier)
- Shifra 2: Konkurrenca (S-Individuale, D-Çifte, X-Përzier)
- Shifrat 3 e 4: Grupmosha (08,10,11,12,14,16,18,AD,35,55).

Shembull: MS14 nënkupton meshkujt, konkurrenca individuale, grupmosha 14 e më ulët.

7.5. Se cilat kategori mbahen për secilën lloj gare varet nga mundësitë dhe interesimi, dhe vendosen nga Bordi në fillim të vitit.



I Sistemi i garave

- 8.1. Kampionati i Tenisit i Kosovës bazohet mbi një numër të turneve që mbahen gjatë një sezoni siç parashihen në kalendarin zyrtar. Tenistët fitojnë pikë në çdo turne ku marrin pjesë, varësisht plasmanit dhe numrit të pjesëmarrësve, në përputhje me Rregulloren #04 për [Pikët e rangimit](#). Tenisti që gjatë një sezoni ka arritur të mbledh më së shumti pikë në një grupmoshë të caktuar, shpallet “Kampion i Tenisit i Kosovës” për atë grupmoshë dhe vit.
- 8.2. Turnet përmbyllës ‘Masters Finals’, janë turne përmbyllës të sezonit ku marrin pjesë katër ose tetë tenistët (shtetas të Kosovës) me më së shumti pikë të akumuluar gjatë vitit, brenda dhe jashtë vendit, në grupmoshë të caktuar. Fituesi i turneut shpallet “Fitues i turneut Masters”.
- 8.3. Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor mbahet me short eliminimi të ekipeve (klubeve) të paraqitura për atë edicion, ku fituesi i përballjes në mes të dy ekipeve përcaktohet pas realizimit të dy (2) fitoreve nga njëri ekip. Ekipi që e fiton finalen shpallet “Fitues i Kampionatit Ekipor” për atë edicion.
- 8.4. Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës është turne që feston sportin e tenisit, i hapur për të gjitha grupmoshat, me kombinim të grupeve kualifikuese pasuar nga shorti i eliminimit, dhe i cili luhet me top të “Kuç” në fushë të “Kuç”. Fituesi i turneut shpallet “Kampion i Kosovës në Mini-Tenis” për atë vit.
- 8.5. Kampionati i Tenisit në Rërë i Kosovës dhe Kampionati i Tenisit mbi Karroca i Kosovës mbahen në parimin e njëjtë sikurse Kampionati i Tenisit i Kosovës; pra tenistët mbledhin pikë rangimi në një sërë turnesh gjatë sezonit, dhe “Kampion” i vitit shpallet tenisti që ka akumuluar më së shumti pikë në grupmoshën përkatëse. Shpallja e kampionëve vlen vetëm nëse janë mbajtur së paku dy (2) turne gjatë sezonit në atë grupmoshë.
- 8.6. Tek kampionatet e shtjelluara nën 8.1 dhe 8.5 të kësaj rregulloreje, në rast se dy tenistë në fund të sezonit për grupmoshë kanë pikë të barabarta, ata do të veçohen sipas këtij prioriteti:
 - a) Tenisti me numër më të madh të turneve të fituar;
 - b) Tenisti me më shumë fitore në përballjet e tyre direkte të kampionatit;
 - c) Tenisti me numër më të madh të finaleve; dhe
 - d) Tenisti me numër më të madh të fitoreve kundrejtë humbjeve gjatë kampionatit.



I Dimensionet e fushës dhe rekuizitat

- 9.1. Kampionati i Tenisit i Kosovës, garat për Grupmoshën “08-“ luhen në fushë të “Kuqe”, me topa të “Kuq” dhe reketa siç përcaktohen në Rregullat e Tenisit.
- 9.2. Kampionati i Tenisit i Kosovës, garat për Grupmoshën “10-“ mbahen në fushë të “Portokalltë”, me topa të “Portokalltë” dhe reketa siç përcaktohen në Rregullat e Tenisit.
- 9.3. Kampionati i Tenisit i Kosovës, garat për Grupmoshën “11-“ mbahen në fushë të rregullt, me topa të “Gjelbër” dhe reketa siç përcaktohen në Rregullat e Tenisit.
- 9.4. Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës, ku luajnë të gjitha grupmoshat në një grupim, mbahen në fushën e “Kuqe” dhe me topa të “Kuq” siç përcaktohet në Rregullat e Tenisit, si dhe reketa sipas dëshirës.
- 9.5. Për të gjitha garat e tjera vlejnë dimensionet e rregullta të fushës, dhe topa e reket standard siç parashihen me Rregullat e Tenisit përkatëse.

II Afatet për paraqitje dhe hedhjen e shortit

- 10.1. Për turnetë e Kampionatit të Kosovës në Tenis, grupmoshat ROG:
 - a) Paraqitja duhet të bëhet më së voni deri më 17:00, një (1) ditë para fillimit të turneut duke u lajmëruar tek Federata përmes email-it në tour@tenniskosova.com dhe duke vënë cc Organizatorin, me mundësi që tenistët të pranohen edhe ditën e turneut pesëmbëdhjetë (15) minuta para orarit për fillim të turneut të përcaktuar nga Organizatori për grupmoshën përkatëse.
 - b) Hedhja e shortit bëhet nga Mbikëqyrësi me së paku dy prindër prezent pesëmbëdhjetë (15) minuta para orarit për fillim të turneut të përcaktuar nga Organizatori për grupmoshën përkatëse. .
 - c) Mbikëqyrësi menjëherë duhet t’i publikojë shortet në portal, ose ta njoftojë Komisararin për pjesëmarrësit dhe detajet e shortit të hedhur.
 - d) Mbikëqyrësi duhet të vendos shortin dhe orarin e meqeve në vend të qasshëm për të gjithë të pranishmit.
- 10.2. Për garat e Kupës së Kosovës në Tenis Ekipor:
 - a) Klubet duhet të paraqiten me e-mail tek tour@tenniskosova.com, 14 ditë para mbajtës së turneut.
 - b) Hedhja e shortit duhet të bëhet nga Mbikëqyrësi, Komisarari dhe një person i tretë, 1 ditë para fillimit të turneut. Shorti dhe orari duhet publikohen në courhive.



- 10.3. Për turnetë e Kampionatit të Kosovës në Tenis, grupmoshat Junior, A dhe Veteran, si dhe të gjitha garat e tjera:
- Tenistët duhet të paraqiten në turne duke u lajmëruar tek Federata përmes email-it në tour@teniskosova.com dhe duke vënë cc Organizatorin, më së voni deri më 17:00, një (1) ditë para fillimit të turneut. Ky afat shërben edhe si afat i fundit për t'u çregjistruar nga turneu. Me këtë rast, Organizatori dhe Komisari duhet të bashkëveprojnë për t'u siguruar se i kanë emrat e të gjithë të regjistruarve përhedhjen e shortit.
 - Me rastin e paraqitjes për turne tenisti për herë të parë është i obliguar që në email të bashkëngjisë dokumentin e identifikimit të lojtarit (letërnjoftim, pasaportë, certifikatë lindjeje), dhe certifikatën mjekësore valide.
 - Tenisti (ose ekipi) që çregjistrohet pas afatit ose nuk paraqitet në turne, pa pasurarsye objektive, ndëshkohet me pikë rangimi siç përcaktohet në [Rregulloren #04](#). Vonesa prej më shumë se pesëmbëdhjetë (15) minuta për cilëndo ndeshje në short eliminimi nënkupton diskualifikim nga turneu.
 - Shorti hedhet nga Komisari, në orën 18:00 ditën para fillimit të turneut. Mbikëqyrësi duhet të kyçet (jetë prezent) gjatë hedhjes së shortit. Komisari zëvendësohet nga Sekretari, nëse ky i pari ka konflikt të mundshëm të interesit.
 - Orari i ndeshjeve duhet të publikohet nga Mbikëqyrësi jo më vonë se ora 21:00 ditën para fillimit të turneut.
 - Për turnetë në çifte, shorti hedhet nga Mbikëqyrësi, para fillimit të garës në çifte. Të njëjtat duhet të publikohen menjëherë.

II Formati i turneve “ROG” të Kampionatit të Kosovës në Tenis

III.1. Kushtet e përgjithshme për formatin e turneve “ROG” janë si në vijim:

- Garat fillimisht mbahen në grupe RR, me 3-5 tenistë në grup varësisht numrit të përgjithshëm të tenistëve.
- Nëse rast se janë dyzet (40) tenistë a më pak, ndarjet e avancimet bëhen si nëvijim:

Numri i tenistëve	Numri i grupeve	Raundi ku avancon	Kalojnë në eliminime
≤ 5	1	Nuk ka	Nuk mbahet
6- 10	2	SF	1-shi dhe 2-shi nga secili grup
11-14	3	SF	1-shi nga secili grup dhe 2-shi më i mirë
15-20	4	SF	1-shi nga secili grup
21-24	6	QF	1-shi nga secili grup dhe dy 2-shat më të mirë
25-40	8	QF	1-shi nga secili grup



- c) Në rast se janë mbi dyzet (40) tenistë do të krijohen grupe me nga tre (3) tenistë, me avancim të tenistit që rreshtohet i pari në grup, dhe i cili avancohet në raundin më të lartë të mundshëm (R16, R32, R64 ... e kështu me radhë).
- d) Varësisht numrit të pjesëmarrësve në turne, Federata mund ta shpërblejë Organizatorin si në vijim: (a) 75€ për 60-74 tenistë; (b) 100€ për 75-99 tenistë; dhe (c) €150 për 100+ tenistë.

11.2. Formati i meçeve në turnetë ROG dhe avansimet caktohen si në vijim:

11.2.1. Formati i meçeve për turnetë RED:

- a) Në fazën e grupeve meçet luhen me numër standard pikësh (x), varësisht grupmoshës. Në një meç tenisti i fiton 0 deri x pikë, dhe këto pikë të fituara i shtohen totalit të pikëve që ai tenist i ka fituar në fazën e grupeve.
- b) Në fund të meçeve në grup, tenisti që ka mbledhur më së shumti fitore, radhitet i pari në grup.
- c) Kur dy a më shumë tenistë kanë diferencë të barabartë të pikëve, përparësi do të ketë tenisti: (1) që ka fituar meçin e tyre direkt; (2) me më shumë pikë të fituara; (3) me më pak pikë të humbura; dhe (4) me raport më të mirë pikë/meç. Nëse as pas kësaj tenistët nuk kanë dallim, ata do të luajnë ashtu që i pari që fiton pesë (5) pikë, avancohet tutje.
- d) Kur jo çdo grup e ka numrin e njëjtë të tenistëve, në grupet me më shumë lojtarë, rezultatet e tenistëve kundrejt tenistit të fundit në ato grupe, injorohen për qëllime të krahasimit sipas pikës c) sipër.
- e) Nëse një tenist nuk i ka përfunduar të gjitha meçet, rezultatet e tij nuk do të merren parasysh për qëllime të krahasimit sipas pikës c) dhe d) sipër.
- f) Në rast të presioneve kohore, siç e vlerëson Mbikëqyrësi, meçet në fazën e grupeve mund të luhen edhe me pikë alternative.
- g) Pikët standarde, dhe alternative, për lojë në grupe dhe në eliminime, janë:

Grupmosha	Poentimi Standard		Poentimi Alternativ	
	Grup	Eliminime	Grup	Eliminime
08-	15 pikë	2STB(7) të fituar DP	11 pikë	1STB(7) DP



11.2.2. Formati i meçeve për turnetë Orange dhe Green:

- a) Në fazën e grupeve meçet luhen me numër standard pikësh, në orange deri në 1 super tie- break të fituar, kurse në finale deri në dy supertie-break.
- b) Në fazën e grupeve meçet luhen me numër standard pikësh, në green deri në 1 set deri në katër (4) gema të fituar, kurse në finale deri në dy seta deri në katër (4) gema.
- c) Në fund të meçeve në grup, tenisti që ka mbledhur më së shumti fitore, radhitet i pari në grup.
- d) Kur dy a më shumë tenistë kanë diferencë të barabartë të pikëve, përparësi do të ketë tenisti: (1) që ka fituar meçin e tyre direkt; (2) me më shumë pikë të fituara; (3) me më pak pikë të humbura; dhe (4) me raport më të mirë pikë/meçe. Nëse as pas kësaj tenistët nuk kanë dallim, ata do të luajnë ashtu që i pari që fiton pesë (5) pikë, avancohet tutje.
- e) Kur jo çdo grup e ka numrin e njëjtë të tenistëve, në grupet me më shumë lojtarë, rezultatet e tenistëve kundrejt tenistit të fundit në ato grupe, injorohen për qëllime të krahasimit sipas pikës c) sipër.
- f) Nëse një tenist nuk i ka përfunduar të gjitha meçet, rezultatet e tij nuk do të merren parasysh për qëllime të krahasimit sipas pikës c) dhe d) sipër.
- g) Në rast të presioneve kohore, siç e vlerëson Mbikëqyrësi, meçet në fazën e grupeve mund të luhen edhe me pikë alternative.

11.3. Krahas obligimit për të pasur Mbikëqyrës, sipas pikës 6.8, nuk ka kërkesa të tjera për referë e gjyqtarë të licencuar për turnetë “ROG”. Megjithatë, Organizatori ka për obligim që të ofrojë ndihmës për ta kontrolluar mbarëvajtjen e meçeve, dhe për ta informuar Mbikëqyrësin për rezultatet e meçeve.

11.4. Kërkesat për fusha për turnetë “ROG” janë: Kuq (08-) 4 fusha; Portokall (10-) 2 fusha; dhe Gjelbër (11-) 2 fusha;

11.5. Organizatori ka për obligim të sigurojë:

- a) Ujë të mjaftueshëm për çdo lojtar;
- b) Çadra / hije në pjesët e pritjes;

11.6. Mbikqyrësi i turneut ‘ROG’ duhet të ndërprej ose të anulojë turnun në rast se arrihen temperaturat ekstreme. Temperatura minimale është 10 gradë Celcius, ndërsa temperatura maksimale 32 gradë Celcius.



12.1. Kushtet e përgjithshme për formatin e turneve “Junior” dhe “A” janë si në vijim:

- Garat mbahen me short të eliminimit nga xhiro R64 deri në Finale, me përjashtim turnet e grupmoshës U12. Nëse në një turne janë paraqitur 6 e më pak lojtarë, turneu mund të mbahet me short Round-Robin, ndërsa nëse janë 7 e më shumë lojtarë turneu mbahet me short të eliminimit. Formatin e mbajtjes së turneut përcaktohet në bashkëpunim me organizatorin e turneut dhe mbikqyrësinë duke u bazuar në kushtet infrastrukturore me qëllim që turneu të përfundojë me sukses.
- Në rast se janë tre (3) ose më pak lojtarë, turneu anulohet.
- Nëse rast se janë mbi gjashtëdhjetë e katër (64) tenistë, dyzet (40) tenistët me rangim më të mirë sipas paragrafit 12.2 më poshtë, plus tetë (8) wildcards që i cakton Organizatori, futen direkt në shortin kryesor, ndërkaq tenistët e tjerë luajnë kualifikime në po aq xhiro sa janë të nevojshme për t'i plotësuar gjashtëmbëdhjetë (16) vendet e lira në shortin kryesor (nga lartë-poshtë në skemë).
- Numri i tenistëve e përcakton madhësinë e shortit dhe numrin e bartësve, si në vijim:

Pjesëmarrës	Shorti	Bartës
4	SF	2
5- 8	QF	2
9-16	R16	8
17-32	R32	8
32-64	R64	16

Grupmosha U12 Shorti Round Robin

Numri i tenistëve	Numri i grupeve	Raundi ku avancon	Kalojnë në eliminime
≤ 5	1	Nuk ka	Nuk mbahet
6	2	SF	1-shi dhe 2-shi nga secili grup

- Shorti për kualifikime hedhet një ditë para fillimit të kualifikimeve, të cilat duhet të përfundojnë së paku para afatit për hedhjen e shortit kryesor.
- Nëse një tenist, pjesëtar në shortin kryesor, tërhiqet pas hedhjes së shortit, ai mund të zëvendësohet me një tenist, të tërhequr me short, nga emrat e tenistëve që kanë humbur në xhiron finale të kualifikimeve.
- Në asnjë rast, nuk lejohet paraqitja e tenistëve shtesë, apo përfshirja e tyre në short, nëse shorti tashmë është publikuar.
- Në rast se numri i tenistëve është më i vogël sesa numri i vijave në skemën e turneut, vendet e lira Bye (pa lojë) caktohen në vijat për takimet më bartësit, duke filluar nga bartësi i parë e më poshtë.
- Në rast se numri i vendeve të lira në skemën e turneut është më i madh sesa numri i



bartësve, vendet e lira Bye caktohen me short në të dyja gjysmat e skemës.

12.2. Përcaktimi i bartësve bëhet sipas parimeve në vijim:

- Shtetasi i huaj mund të caktohet bartës i turneut nëse ka rangim më të mirë ndërkombëtar sesa tenisti vendor.
- Bartësit në short për Junior përcaktohen së pari sipas ranglistës për kategoripërkatëse të: (1) ETF; (2) Federatës.
- Bartësit në short për Adult përcaktohen së pari sipas ranglistës për kategori përkatëse të: (1) ATP, WTA; (2) ITF Futures; (3) Federatës.

12.3. Formati i meçeve në turnetë “Junior” dhe “A”, dhe kërkesat për topa, janë si në vijim:

- Meçet luhen me numër standard setash dhe gemash, varësisht grupmoshës.
- Secila kanë edhe kërkesat minimale për topa të ri, si dhe ndërrim të topave.
- Në rast se një top humb, Organizatori do t’i ofrojë një top zëvendësues në gjendje afërsisht të ngjashme me topin e humbur.
- Mund të luhen edhe kombinime alternative në rast të presioneve kohore, nëse këtë e vlerëson Mbikëqyrësi.
- Formatet, dhe kërkesat për topa të ri, standarde dhe alternative, për meçe individuale janë:

Grupmosha	Aranzhimi Standard		Aranzhimi alternativ	
	Peontimi	Kërkesa për topa	Peontimi	Kërkesa për topa
12-	2S S ₃ =STB(10)	3S ₁	2S(4) S ₃ =STB(10)	3S ₁
14-	2S S ₃ =Normal	3S ₁ + 3S ₃	2S(4) S ₃ =S(4)	3S ₁
16-	2S S ₃ =Normal	3S ₁ + 3S ₃	2S(4) S ₃ =S(4)	3S ₁
18-	2S S ₃ =Normal	3S ₁ + 3S ₃	2S(4) S ₃ =S(4)	3S ₁
AD	2S S ₃ =Normal	3S ₁ + 3S ₃	-	-

S – Set normal / S_x – Seti x / S(4) - Set deri 4 gema, TB(7) në 4:4

- Për ndeshjet në çifte, pavarësisht grupmoshës mbahet formati i shortit kryesor me eliminime. Duhet të ofrohen vetëm tre (3) topa të ri në setin e parë, ndërkaq luhet me poentim standard me dy seta të fituar ku S₃=STB(10), apo poentim alternativ me dy seta të shkurtër me nga 4 gema, ku S₃=STB(10).



- e gjyqtarë të licencuar për turnetë “Junior”. Megjithatë, Organizatori rekomandohet të ofrojë ndihmës për ta kontrolluar mbarëvajtjen e meçeve, dhe për ta informuar Mbikëqyrësin për rezultatet e meçeve.
- 12.5. Krahas obligimit për të pasur Mbikëqyrës, sipas pikës 6.8, kërkesat e tjera minimale për referë e gjyqtarë të licencuar për turnetë “A” janë:
- Finalja duhet të ketë gjyqtarin e karriges dhe së paku tre (3) gjyqtarë të vijave.
 - Gjysmëfinalet duhet të kenë së paku gjyqtarin e karriges.
- 12.6. Në asnjë mënyrë nuk lejohet që gjatë një meçi kampional të kategorive “Junior” dhe “A”, si gjyqtar i karriges të shërbejë një gjyqtar që nuk është i licencuar nga Federata si i tillë. Lista e gjyqtarëve të licencuar mirëmbahet në uebfaqen e Federatës.
- 12.7. Kërkesat për fusha janë të ketë së paku një (1) fushë të përmasave standarde. Krahas kësaj Organizatori ka për obligim të sigurojë:
- Ujë të mjaftueshëm për çdo lojtar;
 - Ulëse dhe çadër për hije në fushë, kur lojtarët ndërrojnë anët;
 - Ulëse për gjyqtarin e karriges;
 - Tabelën për shënimin e rezultateve;
 - Vendin për publikim të shortit, orarit të lojës, dhe vendosje të rezultateve.
- 12.8. Mbikëqyrësi i turneu duhet të ndërprejë ose të anulojë turneun në rast se arrihen temperaturat ekstreme. Temperatura minimale është 10 gradë Celcius, ndërsa temperatura maksimale 35 gradë Celcius.

¶ **Formati i turneve “Veteran” të Kampionatit të Kosovës në Tenis**

- 13.1. Kushtet e përgjithshme për formatin e turneve “Veteran” janë si në vijim:
- Femrat mund të marrin pjesë në turnetë “Veteran” të meshkujve;
 - Nëse pjesëmarrës në grupmoshën e caktuar janë nëntë (9) deri gjashtëmbëdhjetë (16) tenistë, garat mund të mbahen direkt me short kryesor, ose fillimisht në grupe RR e më pas me short kryesor.
 - Më pak se nëntë (9) tenistë fillimisht mbahen grupet RR, ndërkaq mbi gjashtëmbëdhjetë (16) tenistë mbahet direkt shorti kryesor.
 - Kur turneu mbahet vetëm me short kryesor (të eliminimit), madhësia e shortit dhe bartësit përcaktohen siç është paraparë për turnetë “A” tek paragrafi 12.1 i kësaj Rregullore.
 - Edhe dispozitat e tjera të paragrafit 12.1 të kësaj Rregullore, të gjitha vlejnjë për turnetë “Veteran”.
 - Kur garat mbahen me grupe, numri i bartësve do të jetë i barabartë me numrin e grupeve, ndërkaq numri i grupeve si dhe cilët tenistë avancojnë tutje caktohen sipas tabelës në vijim:

Numri i tenistëve	Numri i grupeve	Raundi ku avancon	16	Kalojnë në eliminime
-------------------	-----------------	-------------------	----	----------------------



≤ 5	1	-	Nuk mbahet
6-10	2	SF	1-shi dhe 2-shi nga secili grup
11-14	3	SF	1-shi nga secili grup dhe 2-shi më i mirë
15-16	4	SF	1-shi nga secili grup

- g) Në grupe, Tenisti që ka më së shumti fitore, radhitet i pari në grup.
- h) Kur dy a më shumë tenistë kanë numër të barabartë fitoresh, përparësi do të ketë tenisti:
(1) që ka fituar meçin e tyre direkt; (2) me dallim më të volitshëm të setave të fituar kundrejt humbur; (3) me dallim më të volitshëm të gemave të fituar kundrejt humbur; dhe (4) me dallim më të volitshëm të setave të fituar kundrejt të luajtur dhe gema të fituar kundrejt të luajtur. Nëse as pas kësaj tenistët nuk kanë dallim, radhitja caktohet me short.
- i) Kur jo çdo grup e ka numrin e njëjtë të tenistëve, në grupet me më shumë lojtarë, rezultatet e tenistëve kundrejt tenistit të fundit në ato grupe, injorohen për qëllime të krahasimit sipas pikës h) të këtij paragrafi.
- j) Nëse një tenist nuk i ka përfunduar të gjitha meçet, rezultatet e tij nuk do të merren parasysh për qëllime të krahasimit sipas pikës h) dhe i) sipër.

13.2. Përcaktimi i bartësve bëhet sipas parimeve në vijim:

- a) Shtetasi i huaj mund të caktohet bartës i turneut nëse ka rangim më të mirë ndërkombëtar sesa tenisti vendor.
- b) Bartësit në short përcaktohen së pari sipas ranglistës për kategori përkatëse të: (1) ATP, WTA; (2) ITF Seniors; (3) Federatës.

13.3. Formatet e meçeve në turnetë “Veteran”, dhe kërkesat për topa, janë si në vijim:

- a) Secili meç duhet të ketë së paku tre (3) topa të ri, dhe nuk ka ndërrim të topave.
- b) Në rast se një top humb, Organizatori do t’i ofrojë një top zëvendësues në gjendje afërsisht të ngjashme me topin e humbur.
- c) Varësisht mundësive dhe presioneve kohore, Mbikëqyrësi në bashkëpunim me Organizatorin caktojnë formatin e meçeve.
- d) Formatet standarde dhe alternative për meçet individuale janë:

Xhiro	Standard	Alternativat
RR	2S(4) ku $S_3=STB(10)$	1S ose 1S(9)
R64	2S(4) ku $S_3=STB(10)$	1S ose 1S(9)
R32	2S ku $S_3=STB(10)$	3S(4) ose 1S(9)
R16	2S ku $S_3=STB(10)$	3S(4) ose 1S(9)
QF	2S ku $S_3=STB(10)$	3S(4) ose 1S(9)
SF	2S ku $S_3=STB(10)$	3S(4) ose 1S(9)
F	2S ku $S_3=Normal$	2S ose $S_3=STB(10)$

S(4) - Set deri 4 gema, TB(7) në 4:4

/ S(9) - Set deri 9 gema, TB(7) në 8:8

xS – x Seta normal

- e) Përndeshjet në çifte, mbahet formati i shortit kryesor me eliminime. Duhet të ofrohen



vetëm tre (3) topa të ri në setin e parë, ndërkaq luhet me poentim standard me dy seta të fituar ku $S_3=STB(10)$, apo poentim alternativ me dy seta të shkurtër me nga 4 gema, ku $S_3=STB(10)$.

- 13.4. Krahas obligimit për të pasur Mbikëqyrës, sipas pikës 6.8, nuk ka kërkesa të tjera për referë e gjyqtarë të licencuar për turnetë “Veteran”. Megjithatë, Organizatori rekomandohet të ofrojë ndihmës për ta kontrolluar mbarëvajtjen e meçeve, dhe për ta informuar Mbikëqyrësin për rezultatet e meçeve.
- 13.5. Në asnjë mënyrë nuk lejohet që gjatë një meçi kampional të kategorive “Veteran”, si gjyqtar i karriges të shërbejë një gjyqtar që nuk është i licencuar nga Federata si i tillë. Lista e gjyqtarëve të licencuar mirëmbahet në uebfaqen e Federatës.
- 13.6. Kërkesat për fusha janë të ketë së paku një (1) fushë të përmasave minimale. Krahas kësaj Organizatori ka për obligim të sigurojë:
- a) Ujë të mjaftueshëm për çdo lojtar;
 - b) Ulëse dhe çadër për hije në fushë, kur lojtarët ndërrojnë anët;
 - c) Tabelën për shënimin e rezultateve;
 - d) Vendin për publikim të shortit, orarit të lojës, dhe vendosje të rezultateve.
- 13.7. Mbikqyrësi i turneut duhet të ndërprejë ose të anulojë turneun në rast se arrihen temperaturat ekstreme. Temperatura minimale është 10 gradë Celcius, ndërsa temperatura maksimale 35 gradë Celcius.

¶ Turnet përmbyllës ‘Masters Finals’

- 14.1. Turneu përmbyllës ‘Masters Finals’, është turne përmbyllës i vitit për grupmoshat “Junior” dhe “A”, në të cilin mund të marrin pjesë vetëm tenistët, shtetas të Kosovës, të cilët kanë akumuluar më së shumti pikë gjatë vitit kalendarik në Kampionatin e Tenisit të Kosovës.
- 14.2. Për të qenë nikoqir i turneve Klubet / Organizatorët duhet të aplikojnë tek Komisari sëpaku një (1) muaj para se të fillojë turneu. Në mungesë të aplikacioneve (të suksesshme), Komisari do të vendos për lokacionin se ku do të mbahen turnetë

Numri i grupeve si dhe numri i tenistëve pjesëmarrës në turnetë përmbyllëse për kategori përkatëse është e përcaktuar në tabelën më poshtë:

Kategoria	Grupe RR që formohen	Tenistë që kualifikohen
U12-18	1	4
Adults	2	8

- 14.3. Tenistët kualifikohen automatikisht (plotësojnë pozitat në turne) – bazuar në ranglistën zyrtare në fuqi në ditën e martë të javës kur fillon turneu (vetëm pikët e fituara gjatë vitit kalendarik).



- 14.4. Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të turneut, Komisari i njofton tenistët e kualifikuar automatikisht, si dhe tre tenistë rezervë, për lokacionin dhe datat kur mbahet turneu. Tenistët duhet ta konfirmojnë pjesëmarrjen, gjegjësisht gatishmërinë për të qenë rezervë, së paku shtatë (7) ditë para fillimit të turneut.
- 14.5. Në rast se ndonjëri nga tenistët e kualifikuar për pjesëmarrje, qoftë nuk e konfirmon pjesëmarrjen në kohë qoftë tërhiqet para se ta ketë luajtur meçin e parë, vendi i boshatisur do t'i ofrohet tenistit të radhës në ranglistë.
- 14.6. Formati i meçeve dhe kërkesat për topa duhet të jenë ato Standarde të përcaktuara në paragrafin 12.3.e), përkatësisht 13.3.d) të kësaj Rregullore.
- 14.7. Garat mbahen në formatin RR me nga katër (4) tenistë në një grup. Orari i meçeve përcaktohet si në vijim:
- Xhiro 1 (RR1): T₁ kd T₄ dhe T₂ kd T₃;
 - Xhiro 2 (RR2): T₁ kd T₃ dhe T₂ kd T₄;
 - Xhiro 3 (RR3): T₁ kd T₂ dhe T₃ kd T₄;
- 14.8. Në përcaktimin e radhitjes përfundimtare në grup konsiderohen këto elemente:
- Nëse njëri tenist nuk i luan të gjitha meçet në grup, meçet e zhvilluara të atij lojtari nuk do të merren parasysh kur krahasohen plasmanet e tenistëve të tjerë në grup;
 - Prioritet në radhitje ka tenisti me: (1) më shumë fitore; (2) më shumë meçe të kompletuara; (3) dallim më të favorshëm të setave të fituar kundrejt setave të luajtur; (4) dallim më të favorshëm të gemave të fituar kundrejt atyre të luajtur; dhe (5) fitues në përballje direkte;
 - Në rast se pika b) sipër nuk e përcakton fituesin e grupit, tenistët përkatës luajnë STB(10) deri sa të ketë një fitues.
 - Në rastet kur turneu mbahet me vetëm një grup, fituesi i grupit shpallet edhe fitues i Kupës.
 - Në rastet kur turneu mbahet me dy grupe, dy të parët e secilit grup kualifikohen për gjysmëfinale, ku fituesi i grupit të parë ndeshet me të dytin në grupin e dytë dhe fituesi i grupit të dytë ndeshet me të dytin në grupin e parë. Fituesit e gjysmëfinaleve ndeshen në finale për ta caktuar fituesin e Kupës.
- 14.9. Krahas obligimit për të pasur Mbikëqyrës, sipas pikës 6.8, nuk ka kërkesa të tjera për referë e gjyqtarë të licencuar për turnetë “Junior”, ndërkaq kërkesat e tjera minimale për turnetë “A” janë:
- Finalja duhet të ketë gjyqtarin e karriges dhe së paku tre (3) gjyqtarë të vijave.
 - Gjysmëfinalet duhet të kenë së paku gjyqtarin e karriges.



15. Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor

- 15.1. Tarifa për pjesëmarrje për secilin ekip është paraparë me Rregulloren #02 të Federatës për Tarifat, dhe duhet të paguhet para se të hedhet shorti, në të kundërtën ekipi merret si jo i paraqitur.
- 15.2. Shpërblimet për pjesëmarrje dhe arritje të secilit ekip, janë përcaktuar me Rregulloren #03 të Federatës për Financat. Nëse ekipi tërhiqet nga garat pas shortit, ose nuk paraqitet për ndonjë përballje me numër minimal lojtarësh (dy), i njëjti gjobitet me pesëdhjetë euro (50€) dhe humb të drejtën në shpërblimin e arritjes.
- 15.3. Gara e Kupës së Kosovës në Tenis Ekipor mbahet brenda një jave kalendarike, dhe në një lokacion të vetëm i cili caktohet në Komisari në bashkëpunim me klubet.
- 15.4. Gara mbahet me sistem të eliminimit, ku madhësia e shortit varet nga numri i ekipeve që paraqiten në mënyrën dhe afatet e parapara me paragrafin 10.2 të kësaj Rregullore. Me rastin e paraqitjes, përfaqësuesi i klubit duhet t'i posedojë pëlqimin e lojtarëve (nënshkrimin e tyre).
- 15.5. Ekipi pjesëmarrës në Kupën e Kosovës në Tenis Ekipor duhet të ketë minimum dy (2) lojtarë dhe maksimumi katër (4) lojtarë për kategorinë meshkuj, e njëjta vlen edhe për kategorinë femra. Ekipi ka të drejtë përfshirjen e lojtarëve mysafirë (nga jashtë Kosovës) në ekip me numër të pakufizuar, këta lojtarë duhet të paraqiten bashkë me pjesën tjetër të ekipit sipas afateve të parapara me paragrafin 10.2 të kësaj Rregullore.
- 15.6. KRTK përcakton Mbikëqyrësin e përgjithshëm të edicionit, i cili është përgjegjës për hedhjen e shortit dhe koordinimit të garës në bashkëpunim të ngushtë me Komisararin.
- 15.7. Bartësi caktohen si në vijim:
 - a) Bartës i parë vendoset ekipi fitues i edicionit paraprak.
 - b) Bartës i dytë ekipi finalist i edicionit paraprak.
 - c) Bartës të tretë dhe katërt caktohen gjysmëfinalistët e edicionit paraprak.
 - d) Në rast se ndonjëri nga ekipet e sipërpërmendura nuk paraqitet (ose është i diskualifikuar) për ndonjë arsye të caktuar, atëherë të gjithë ekipet e tjera të renditura nën këtë ekip, ngriten një pozitë më lartë për qëllime të caktimit të bartësve.
- 15.8. Shorti hedhet në afatin e paraparë me paragrafin 10.2 të kësaj Rregullore, sipas procedurës në vijim:
 - a) Bartësi i parë vendoset në gjysmën e epërme të shortit, ndërkaq bartësi i dytë në gjysmën e poshtme.
 - b) Pozicionimi i bartësve 3 e 4 në short (gjysma e epërme ose e poshtme) caktohet me short: i pari që tërhiqet vendoset në gjysmën e epërme të shortit, ndërkaq i dyti në gjysmën e poshtme.
 - c) Pozicionimi i çerek-finalistëve (ekipet me renditje 5-8) caktohen me short, ku secili që tërhiqet plotëson mbrapsht pozitat e lira duke u nisur nga bartësi 4 e deri tek bartësi 1.
 - d) Parimi i njëjtë sikurse nën c) sipër përdoret tek ekipet me renditje 9-16, ku secili që

- tërhiqet plotëson mbrapsht pozitat e lira duke u nisur nga i rendituri 8 e deri tek bartësi 1. E njëjta procedurë përsëritet nëse ka më tepër se 16 ekipe.
- e) Një edicion mund të mbahet në një lokacion dhe javë të vetme, nëse kështu vendos Bordi. Kusht për këtë është një lokacion me së paku dy (2) ose më shumë fusha me përmasa minimale.
- f) Nëse edicioni nuk mbahet në një javë/lokacion të vetëm:
- i) orari i ndeshjeve përcaktohet nga Komisari në kalendarin zyrtar;
 - ii) kusht për të qenë vendas është së paku një (1) fushë me përmasa minimale;
- 15.9. Shpenzimet e udhëtimit dhe të ushqimit, si dhe të qëndrimit (në rast se fjetja bëhet në mënyrë të organizuar nga federata) për të gjitha ekipet do t'i bartë federata.
- 15.10. Fitues i përgjithshëm i një përballjeje në mes të dy ekipeve është ekipi që arrin t'i fitojë së paku dy (2) meçe për garat e meshkujve, e njëjta vlen edhe për garat e femrave.
- 15.11. Fillimisht luhen dy (2) meçe individuale me format standard me dy (2) seta të fituar, pasuar nga një (1) meç në çifte me format me dy (2) seta të fituar ku seti i tretë është set i plotë.
- 15.12. Kërkesat minimale për topa të ri janë: së paku tre (3) topa në fillim të setit të parë, ndërrimi i parë i topave pas gejmimit të nëntë (9), pastaj ndërrimet e radhës pas çdo njëmbëdhjetë (11) gejma.
- 15.13. Çdo ekip do ta ketë kapitenin e ekipit, i cili do t'i emërojë lojtarët e meçeve individuale pesëmbëdhjetë (15) minuta para fillimit të meçit të parë. Në meçin e parë, lojtari i dytë (i ranguar më lartë) i njërit ekip, ndeshet me lojtarin e dytë (i ranguar më lartë) të ekipit tjetër. Në meçin e dytë, lojtari i parë (i ranguar më lartë) i njërit ekip ndeshet me lojtarin e parë (i ranguar më lartë) të ekipit tjetër. Për të siguruar renditje të saktë përgjegjës është Mbikëqyrësi / gjyqtari i karriges i përballjes. Kur lojtarët nuk janë të ranguar, kapiteni përcakton renditjen e lojtarëve.

Renditja e lojtarëve të një ekipi do të bëhet sipas rangimit të tyre duke u bazuar në ranglistat si në vijim:

- a) ATP/WTA;
- b) Sipas rang-listës së FTK për Adult;
- c) ITF Juniors;
- d) Sipas rang-listës së FTK për junior deri në 18 vjeç;
- e) TE;
- f) Sipas ranglistës së FTK për junior deri në 16 vjeç.



- 15.14. Pas përfundimit të meçeve individuale, kapitenët emërojnë lojtarët për meçin në çifte. Nëse i emëruar është një lojtar që ka luajtur në meçin e dytë, atëherë caktohet pushim prej dyzet e pesë (45) minutash; në të kundërtën meçi në çifte fillon pesëmbëdhjetë (15) minuta pas përfundimit të meçit të dytë.
- 15.15. Kërkesat për referim janë si në vijim:
- Nëse turneu mbahet në një lokacion të vetëm gjatë një jave të vetme, atëherë KRTK cakton gjyqtarët e karriges për turneun si dhe ndihmës referë të angazhuar të cilët më pas Mbikëqyrësi i Përgjithshëm përmes rotacionit i cakton të gjykojnë meçet.
 - Nëse turnetë mbahen në javë dhe lokacione të ndryshme, atëherë Mbikëqyrësi merr përsipër njërën përballje, ndërkaq KRTK i cakton Mbikëqyrësit për përballjet e tjera. Mbikëqyrësi njëherësh shërben edhe si gjyqtar në karrige.
 - Në finale, duhet të ketë edhe së paku tre (3) gjyqtarë të vijave.

Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës

- 16.1. Krahas obligimit për të pasur Mbikëqyrës, sipas pikës 6.8, nuk ka kërkesa të tjera për referë e gjyqtarë të licencuar për turnetë “ROG”. Megjithatë, Organizatori (në këtë rast Federata) ka për obligim që të ofrojë ndihmës për ta kontrolluar mbarëvajtjen e meçeve, dhe për ta informuar Mbikëqyrësin për rezultatet e meçeve.
- 16.2. Lokacioni duhet të përmbajë së paku katër (4) fusha të madhësisë Red, të cilat mund të jenë të improvizuara.
- 16.3. Luhet me “Top të kuq” dhe fushë e rrjetë të dimensioneve të Mini-tennis, ndërkaq nuk ka kufizim për madhësinë e reketit që përdoret.
- 16.4. Nuk ka kufizim as të gjinisë, e as të grupmoshës, që dmth se turneu mbahet i përbashkët për të dyja gjinitë dhe të gjitha grupmoshat.
- 16.5. Tenistët fillimisht marrin pjesë në fazën e kualifikimeve e cila mbahet në 1-32 grupe RR me 4-6 tenistë, varësisht numrit të pjesëmarrësve.
- 16.6. Fillimisht krijohen grupet për tenistët “ROG”, dhe grupet për tenistët “Junior” e më të vjetër. Secili tenist që zë vendin e parë në grup, kualifikohet për fazën e eliminimeve, në R32. Nëse janë më pak se 32 grupe, atëherë vendet e boshatisura plotësohen me vendet e dyta në grupe, sipas parimit të njëjtë të përcaktuar edhe në paragrafin 11.2.c) të kësaj Rregullore.



16.7. Rregullat e lojës janë:

- a) Lojtari që i pari fiton dhjetë (10) pikë, e fiton setin dhe lojën. Në finale, duhet fituar dy seta deri në dhjetë (10) pikë, kur rezultati është 9-9 luhet pika vendimtare e cila përcakton fituesin.
- b) Vlen rregulli i “Shërbimit të dytë.
- c) Nuk lejohen goditjet e forta - pika humbet.
- d) Nuk lejohen goditjet në ajër volej, smeç, etj. (pa e prekur topi fushën) - pika humbet.

II **Kampionati i Tenisit në Rërë dhe mbi Karroca**

Kampionati i Tenisit në Rërë i Kosovës dhe Kampionati i Tenisit mbi Karroca i Kosovës mbahen me rregullat specifike që ato secila i kanë (kërkesat për fusha, topat, reketat, etj.).

Në raport me dispozitat e tjera të kësaj Rregullore (të tilla si: ndarja e grupmoshave, kërkesat për t’u paraqitur në turne, etj.) ato të gjitha vlejné në parimin e njëjtë sikurse edhe tek Kampionati i Tenisit i Kosovës.

III **Pushimet, nxehtet dhe afatet**

18.1. Një tenist mund t’i luajë më së shumti tri (3) takime në të njëjtën ditë, nga këto më së shumti dy (2) në meçe individuale.

18.2. Tenisti ka të drejtë pushimi në mes të dy meçeve individuale varësisht nga gjatësia e takimit të parë, si në vijim:

- a) 30 minuta pushim, nëse takimi i parë ka zgjatur më pak se 60 minuta;
- b) 60 minuta pushim, nëse takimi i parë ka zgjatur më pak se 60-90 minuta;
- c) 90 minuta pushim, nëse takimi i parë ka zgjatur mbi 90 minuta.

18.3. Pas takimit në çifte, tenistët kanë të drejtë pushimi prej 30 minutash.

18.4. Në rast se në ditën e njëjtë duhet të luhen takimet gjysmëfinale dhe takimi final në konkurrencën individuale, dy takimet gjysmëfinale duhet të fillojnë në kohë të njëjtë ndërsa pushimi para takimit final duhet të jetë së paku dy (2) orë.

18.5. Tenisti ka të drejtë pesë (5) minuta nxehte para fillimit të takimit. Në rast se vazhdohet takimi i ndërprerë koha e nxehtes është:

- a) Nuk ka nxehte për ndërprerjet më të shkurtra se 15 minuta;
- b) Tre (3) minuta nxehte për ndërprerjet mes 15-30 minuta; dhe
- c) Pesë (5) minuta nxehte për ndërprerjet mbi 30 minuta.

18.6. Ky nen nuk vlen për grupmoshat “ROG”. 24



18. **Kërkesat e përgjithshme infrastrukturore për organizimin e garave dhe turneve**

19.1. Kërkesat minimale për fusha, varësisht garës dhe grupmoshave, janë si në vijim:

Gara	Përcaktuesi	Numri i fushave
Kampionati i Tenisit i Kosovës	Grupmosha: - Kuq/08- - Portokall/10- - Gjelbër/11- - Tjerët	4 2 2 1
Kupa e Kosovës në Tenis	n/a	1
Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor	Nr. i javëve dhe lokacioneve: - Një i vetëm - Disa	2 1
Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës	-	4
Kampionati i Tenisit në Rrëzë i Kosovës	-	1
Kampionati i Tenisit mbi Karroca i Kosovës	-	1

19.2. Rrjetat në gjendje të mirë dhe pajisja me shkopinjtë mbajtës për lojëindividuale.

19.3. Vijat mirë të dukshme, me dimensione të duhura, dhe gjendje të mirë.

19.4. Ulëse dhe çadër për hije në fushë, kur lojtarët pushojnë me rastin e ndërrimit të anëve.

19.5. Ulëse dhe çadër për hije për gjyqtarin e karriges në garat ku referimi në karrige është obligativ (garat e grupmoshës “A” të Kampionatit të Tenisit të Kosovës, si dhe Kupës së Kosovës në Tenis dhe Tenis Ekipor).

19.6. Tabelën për shënimin e rezultateve.

19.7. Numër të mjaftueshëm të pajisjeve për mirëmbajtjen ditore dhe për pastrimin e terrenit në kohën sa më të shkurtër pas ndërprerjes së lojës për shkak të kushteve atmosferike.

19.8. Vendin për publikim të shortit, orarit të lojës, dhe vendosje të rezultateve.



1 Kërkesat për topa

- 20.1. Së paku një (1) top i Kuq për çdo meç (jo patjetër top i ri) në turnetë e:
- Kampionatit të Kosovës në Tenis, Grupmosha “08-“ (“Kuq”); dhe
 - Kampionatit të Kosovës në Mini-Tenis.
- 20.2. Së paku dy (2) topa Portokall, gjegjësisht Gjelbër, për çdo meç (jo patjetër topa të ri) në turnetë e Kampionatit të Kosovës në Tenis, Grupmosha “10-“ (“Portokall”), gjegjësisht Grupmosha “11-“ (“Gjelbër”).
- 20.3. Së paku tre (3) topa për lojë profesionale, të ri, të aprovuar nga ITF-ja, në fillim të lojës për të garat e Kampionatit të Kosovës në Tenis, Grupmosha “Veteran”;
- 20.4. Së paku tre (3) topa për lojë profesionale, të ri, të aprovuar nga ITF-ja, në fillim të lojës për të garat:
- Kampionatit të Kosovës në Tenis, grupmoshat “Junior” dhe “A”.
 - Kupa e Kosovës në Tenis.
 - Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor.
- 20.5. Për garat nën 20.4 sipër, së paku edhe tre (3) topa të tjetër të ri, të aprovuar nga ITF-ja, në fillim të setit të tretë, përveç kur seti i tretë luhet me STB(x).
- 20.6. Për garat e Kampionatit të Tenisit në Rërë, nevojiten së paku dy (2) topa për meç, jo patjetër të ri.
- 20.7. Për garat e Kampionatit të Tenisit mbi Karroca, nevojiten së paku tre (3) topa për meç, jo patjetër të ri.
- 20.8. Në çdo rast, një turne, dhe në veçanti një lojë, që nuk është e grupmoshës “ROG”, duhet të fillojë dhe mbarojë me llojin e njëjtë të topave.
- 20.9. Në rast se gjatë lojës humbet një top, Organizatori do t’i ofrojë lojtarëve një top zëvendësues në gjendje afërsisht të ngjashme me topin e humbur.
- 20.10. Federata ofron mbështetje me topa të ri për garat dhe turnetë zyrtare, në përputhje me [Rregulloren #03](#) të Federatës për Financat. Topat e tjerë të nevojshëm duhet të sigurohen nga Organizatori.
- 20.11. Në rast se turneu është anuluar, ndërkohë që Federata i ka siguruar topat, atëherë Organizatori është i obliguar të gjithë topat e pashfrytëzuar t’ia kthejë Federatës. Është obligim i Mbikëqyrësit të raportojë mbi topat e shfrytëzuar.



1 Obligimet e Organizatorit

- 21.1. Organizatori i turneut merr përsipër t'i zbatojë të gjitha obligimet, detyrimet dhe afatet që burojnë nga të gjitha nenet e kësaj Rregulloreje. Në të kundërtën, Organizatori rrezikon të sanksionohet sipas paragrafit 6.11 ose 21.6 të kësaj Rregulloreje.
- 21.2. Organizatori merr përsipër që për çdo ngjarje të tenisit të ofrojë:
- Ujë të mjaftueshëm për çdo lojtar;
 - Ulëse dhe çadër për hije në fushë, kur lojtarët ndërrojnë anët;
 - Ulëse dhe çadër për hije për gjyqtarin e karriges;
 - Rrjetat në gjendje të mirë dhe shkopinj të mbajtës për lojë individuale;
 - Tabelën për shënimin e rezultateve;
 - Vendin për publikim të shortit, orarit të lojës, dhe vendosje të rezultateve.
 - Një mjek / fizioterapeut;
 - Së paku një ndihmës për Mbikëqyrësin (qoftë ajo edhe vetveten);
 - Numër të mjaftueshëm të personave dhe pajisjeve për mirëmbajtjen ditore dhe për pastrimin e fushës në kohën sa më të shkurtër pas ndërprerjes së lojës për shkak të kushteve atmosferike;
 - Logon e Federatës dhe të sponsorëve të vendosur në pjesët anësore të rrjetës, si dhe një vend të zbrazët me madhësi 3x0.75m në të dy anët e fushës për vendosje të paneleve për marketing të sponsorëve;
- 21.3. Organizatori po ashtu merr përsipër që për çdo Mbikëqyrës apo gjyqtar të angazhuar në ngjarje, të sigurojë ujë pa kufizim, si dhe shujtën.
- 21.4. Nëse sasia e topave me të cilën Federata e mbështet një turne është më e vogël sesa nevojat reale, Organizatori ka për obligim me shpenzime të veta ta sigurojë pjesën tjetër të topave.
- 21.5. Organizatori po ashtu merr përsipër që për çdo ngjarje të tenisit t'i mbulojë të gjitha shpenzimet e turneut të cilat nuk mbuloohen nga Federata në përputhje me [Rregulloren #03](#) të Federatës për Financat. Këto përfshijnë, por nuk janë kufizuar në:
- Kostot e topave të nevojshëm përtej atyre të dhuruar nga Federata;
 - Mëditjet / tarifat e gjyqtarëve të vijave;
 - Shujtat e gjyqtarëve;
 - Mëditjet e mjekut / fizioterapeutit;
 - Ujë për lojtarët.
- 21.6. Nëse Organizatori nuk i përmbush kërkesat e kësaj Rregulloreje, ai mund të sanksionohet duke mos iu lejuar të jetë Organizator për një kohë të caktuar, dhe / ose me gjobë prej njëzeteuro deri pesëdhjetë euro (20€-50€) përtej shpenzimit që nuk e ka mbuluar.



¶ **Pikëzimet / Ranglistat**

- 22.1. Për tenistët kosovarë që garojnë në garat ndërkombëtare dhe kombëtare mbahet ranglista zyrtare. Këtu nuk bëjnë pjesë grupmoshat “ROG”;
- 22.2. Tenistët fitojnë pikë në përputhje me [Rregulloren #04](#) të Federatës për Rangim Zyrtar.
- 22.3. Rregullorja #04 po ashtu përcakton afatet dhe përgjegjësitë e publikimit të ranglistave, si dhe turnetë që merren parasysh kur përpilohen të njëjtat.

¶ **Kërkesat për Mbikëqyrës e gjyqtarë**

- 23.1. Për t’u mbajtur një turne zyrtar, për të njëjtin Mbikëqyrësi duhet të jetë i deleguar nga Komisioni Udhëheqës i KRTK-së, në përputhje me [Rregulloren #01](#) të Federatës për KRTK-në, së paku katërmëdhjetë (14) ditë para fillimit të turneut/garës.
- 23.2. Nëse Mbikëqyrësi apo gjyqtari pa arsye dhe pa paralajmërim të mjaftueshëm nuk paraqitet në turne, ai gjyqitet me dyzet euro (40€).
- 23.3. Nëse Mbikëqyrësi në një ditë të caktuar vonohet, ose nuk qëndron shumë, apo shpesh zhduket nga lokacioni, ai mund të gjyqitet deri në mëditjen e plotë.
- 23.4. Për turnetë “A” të Kampionatit të Tenisit të Kosovës dhe Turneve përmbyllës ‘Masters Finals’ kërkesat minimale janë:
 - a) Finalja - Gjyqtarin e karriges dhe së paku tre (3) gjyqtarë të vijave.
 - b) Gjysmëfinalet – Gjyqtarin e karriges.
- 23.5. Për garat e Kupës së Kosovës në Tennis Ekipor kërkesat minimale janë:
 - a) Finalja - Gjyqtarin e karriges dhe së paku tre (3) gjyqtarë të vijave (secilimeç).
 - b) Xhirot e tjera – Mbikëqyrësi kryesor dhe gjyqtarë të karriges sipas mundësive financiare.
- 23.6. Çmimorja për shërbimet e gjyqtarëve parashihet me [Rregulloren #03](#) të Federatës për Financa. E njëjta rregullore përcakton se kur mëditja / tarifa e tyre mbulohet nga Federata.



- 23.7. Rezultatet e të gjitha meçeve në garat e grupmoshës “A” duhet të azhurnohen në kohë reale (LiveScore). Për këtë duhet të sigurohet Mbikëqyrësi ndërkaq Organizatori duhet të ofrojë ndihmës që do ta mirëmbajnë atë nëse nuk ka gjyqtarë të karriges.

¶ **Obligimet e Mbikëqyrësit dhe gjyqtarëve**

- 24.1. Të gjithë gjyqtarët janë të obliguar të kenë gjykim të paanshëm e të drejtë, sjellje profesionale, dhe evitim të konfliktit të interesit. Po ashtu, në çdo kohë duhet respektuar dhe vepruar në përputhje me “Kodin e Sjelljes për Referët” të ITF-së. Në të kundërtën mund të ndëshkohen ose pezullohen nga Komisioni Disiplinor i Federatës.
- 24.2. Gjyqtari i karriges mund ta ndërpresë menjëherë takimin për shkak të motit, ndërkaq Mbikëqyrësi i turneut i ndërpre në takimet qoftë për shkak të territ apo për shkak të motit. Në rast të territ ndërprerja bëhet pas një numri çift të gemave të luajtur në set, apo pas përfundimit të setit.
- 24.3. Mbikëqyrësi është agjent i Federatës, përgjegjës për ta arkëtuar pagesën e anëtarësisë në Federatë për çdo lojtar në turne që ende nuk e ka paguar anëtarësinë. Në rast se lojtari nuk e bën pagesën, Mbikëqyrësi obligohet të mos e lejojë pjesëmarrjen e tij në turne. Në rast se Mbikëqyrësi megjithatë e lejon pjesëmarrjen e lojtarit në turne, supozohet se lojtari e ka paguar anëtarësinë, dhe Mbikëqyrësi bëhet përgjegjës për atë pagesë e cila do t’i ndalet nga mëditja.
- 24.4. Pagesat e grumbulluara të anëtarësisë, Mbikëqyrësi duhet t’i kreditojë në llogarinë bankare të Federatës, ose t’ia dorëzojë Komisarit ose Sekretarit, brenda 48 orëve.
- 24.5. Mbikëqyrësi po ashtu ka për obligim që:
- a) Për çdo lojtar për të cilin mungojnë shënimet në databazë të Federatës tësigurojë:
 - i) dokumentin e identifikimit të lojtarit (letërnjoftim, pasaportë, certifikatë lindjeje). Këtë duhet fotografuar me telefon të mençur dhe ta përcjellë tek Komisari.
 - ii) Deklarimin se cilit klub konsideron se i takon dhe kë e ka trajner kryesor.
 - b) Ta përkujtojë lojtarin (ose prindin / trajnerin) për t’u pajisur me certifikatë mjekësore në rast se ajo i ka skaduar ose i mungon.
 - c) Nënshkrimin për pranim të kushteve të lojës dhe kodit etik të sjelljes (lojtari dhe prindi / trajneri).
- 24.6. Menjëherë pas përfundimit të turneut Mbikëqyrësi është i detyruar që t’i dërgojë Komisarit me e-mail raportin e turneut në formularin e caktuar për këtë qëllim. Raporti i turneut duhet të përmbajë edhe të gjitha rezultatet e turneut dhe shkeljet e rregullave të kodit gjatë turneut.



- 24.7. Nëse Mbikëqyrësi nuk e përdor portalin “CourtHive” për ta menaxhuar dhe hedhur shortin për një turne “ROG”, ai duhet menjëherë (1) së pari pas hedhjes së shortit / grupeve; dhe (2) së dyti pasi të jenë plotësuar rezultatet në to; t’i dërgojë ato me foto tek Komisarari.
- 24.8. Nëse Mbikëqyrësi nuk e përdor portalin “CourtHive” për ta menaxhuar dhe azhurnuar rezultatet për turnetë “Junior” dhe “Veteran”, ai duhet menjëherë pas çdo seti të përfunduar në një meç, t’ia dërgojë rezultatin Komisararit.
- 24.9. Nëse Mbikëqyrësi përdor portalin “CourtHive”, azhurnimi i rezultateve duhet të bëhet në përputhje me shpejtësinë e paraparë me dispozitat 24.7 e 24.8 sipër.
- 24.10. Vonesat në dërgim të rezultateve tek Komisarari, ose në azhurnim të rezultateve, rezultojnë në sanksionim monetar për Mbikëqyrësin - deri në mëditjen e plotë. Vonesat e vazhdueshme mund të rezultojnë në mos angazhime të tjera.

5 Shpërblimet

- 25.1. Organizatori është i obliguar të sigurojë shpërblime (kupa) për finalistët e të gjitha turneve, me përjashtim të turneve “ROG” ku sipas dëshirës mund të shpërndahen mirënjohje ose medalje pa dallime për të gjithë pjesëmarrësit e turneut.
- 25.2. Për turnetë “ROG” dhe “Junior” mund të jepen shpërblime simbolike jo monetare (në natyrë) sipas mundësive dhe sponsorizimit, si në vijim:
- a) Deri në €20 për turnetë “ROG”;
- b) Deri në €50 për turnetë “Junior”.
- 25.3. Në grupmoshën “A” shpërblimet minimale monetare për turne janë:

TURNEU \ VENDI I ZËNË	1	2	3-4	5-8	9-16
Kampionati i Tenisit i Kosovës (Individual)	€300	€150	€80	-	-
Kampionati i Tenisit i Kosovës (Çifte)	€100	€50	-	-	-
Kupa e Kosovës në Tenis (Individual)	€500	€250	€125	€60	-
Kupa e Kosovës në Tenis Ekipor	€500	€250	€125	€50	€30
Kampionati i Mini-Tenisit i Kosovës	-	-	-	-	-
Kampionati i Tenisit në Rrëzë i Kosovës	€100	€50	-	-	-
Kampionati i Tenisit mbi Karroca i Kosovës	€100	€50	-	-	-

- 25.4. Tenisti i cili në grupmoshën “A” në fund të vitit shpallet Kampion i Tenisit i Kosovës, fiton shpërblim monetar të përgjithshëm prej pesëqind euro (€500).



1 Rregullorja Disiplinore

- 26.1. Qëllimi i këtyre rregullave është mbajtja e një rendi të qëndrueshëm dhe të sjellës së mirëtë tenistëve të regjistruar pranë Federatës, të cilët marrin pjesë në garat zyrtare individuale dhe ato ekipore.
- 26.2. Tenisti, trajneri, prindi ose përfaqësuesi i tenistëve nuk lejohet, sidomos gjatë turneut, të sillet në mënyrë që ndikon negativisht për imazhin Federatës apo tenisit në përgjithësi, apo të bëjë gjeste apo sjellje të pahijshme ndaj organizatorëve të turneut, tenistëve tjerë, gjyqtarëve.
- 26.3. Tenisti duhet të sillet në mënyrë sportive gjatë takimit dhe gjatë gjithë kohës sa qëndron në vendngjarjen e turneut.
- 26.4. Gjyqtari i karriges në një takim mban përgjegjësi dhe cakton dënimet për tenistin (në përputhje me “Rregullat e Tenisit” e ITF-së, dhe “Detyrat dhe Procedurat për Zyrtarët” e ITF-së) që nuk sillet sipas rregullave të sjelljes gjatë atij takimi. Në rastet e tjera përgjegjësinë e ka Mbikëqyrësi.
- 26.5. Kodi i sjelljes
- a) *Veshja dhe pajisjet joadekuate*
Tenistët janë të detyruar që të paraqiten në takime me veshje të pastër dhe normale sportive. Është e ndaluar paraqitja me veshje josportive.
 - b) *Largimi nga fusha pa leje*
Tenisti nuk mund të largohet nga tereni gjatë kohës së takimit (duke përfshirë edhe nxehjen) pa lejen e referit kryesor të takimit apo të referit kryesor të turneut.
 - c) *Lëshimi i takimit*
Tenisti duhet ta përfundojë takimin e filluar nëse nuk është lënduar në ndërkohë. Në rast të lëndimit ai duhet ta informojë gjyqtarin e karriges ose të turneut i cili mund të kërkojë mendimin e mjekut zyrtar.
 - d) *Vonesa të panevojshme të lojës*
 - | Tenistët janë të detyruar të e fillojnë takimin pas vendimit të Mbikëqyrësit, pas nxehjes dhe pa ndonjë vonesë të panevojshme ta përfundojnë atë.
 - | Në mes të pikëve mund të kalojnë më së shumti 25 sekonda, përveç gjatë ndërrimit të anëve.
 - | Gjatë ndërrimit të anëve prej momentit të përfundimit të poenit të fundit deri në momentin e goditjes së shërbimit të parë të gemit tjetër mund të kalojnë më së shumti 90 sekonda.



- iv) Pas përfundimit të setit, fillon pushimi që zgjatë 2 minuta prej momentit të përfundimit të poenit të fundit në set deri në momentin e goditjes së topit të parë të setit tjetër.
- | Pranuesi i shërbimit duhet ta përcjell tempon e lojës së shërbyesit dhe duhet të jetë i gatshëm në momentin kur shërbyesi është i gatshëm të shërbejë.
 - | Zvarritja e lojës që vjen si pasojë e humbjes së kondicionit trupor, lëndimit apo refuzimit të vazhdimit të takimit konsiderohet thyerje e këtyre rregullave.
 - | Shkelja e parë e këtyre rregullave do të sanksionohet më vërejtje, ndërsa çdo shkelje tjetër me një poen dënimi. Por, kur tenisti nuk e vazhdon takimin edhe pas thirrjes së gjyqtarit të karriges, atëherë kjo shkelje sanksionohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.
- e) *Shprehjet vulgare*
Tenisti nuk mund të përdorë shprehje vulgare në fushë dhe rreth saj. Si shprehje vulgare vlerësohen secila fjalë e përdorur që njihet si shprehje vulgare (fjalë e ndytë), që është thënë nga tenisti me zë dhe është dëgjuar nga gjyqtari i karriges, ivijave, apo mbledhësit e topave.
- f) *Gjestet e pahijshme*
Tenisti nuk duhet të përdorë gjeste të pahijshme në terren dhe rreth tij. Si gjeste të pahijshme vlerësohen secili gjest me duar, reket apo top të cilat konsiderohen si të turpshme.
- g) *Keqpërdorimi i topit*
Tenisti nuk guxon që në mënyrë të dhunshme apo të zemëruar ta godasë topin me reket ose këmbë në fushë dhe rreth saj, përveç gjatë qëllimit të justifikuar të fitimit të poenit në lojë. Si keqpërdorim i topit vlerësohet secila goditje e qëllimshme e topit përtej rrethojës së fushës, goditje e rrezikshme apo e pamëshirshme e topit brenda fushës pa i ditur pasojat.
- h) *Keqpërdorimi i reketit apo pajisjeve*
Tenisti nuk guxon që në mënyrë të dhunshme apo të zemëruar ta hedh reketin apo ndonjë pajisje tjetër në drejtim të ndonjë objekti tjetër në fushë dhe rreth saj. Si keqpërdorim i reketit apo pajisjeve vlerësohet secila goditje e qëllimshme, e rrezikshme apo e pamëshirshme me reket apo me ndonjë pajisje tjetër në drejtim të rrethës, terrenit, karriges së gjyqtarit apo ndonjë objekti tjetër të përhershëm të fushës.
- i) *Kërcënimi gojor*
Tenisti nuk guxon që gojarisht ta sulmojë apo ofendojë gjyqtarin, kundërshtarin, shikuesit apo cilindo person tjetër në fushë apo rreth saj. Si kërcënim gojor vlerësohet secila thënie e drejtuar ndaj gjyqtarit, kundërshtarit, shikuesit apo cilitdo person tjetër që nënkupton pandershmëri, nënçmim, fyerje apo shpifje.



j) *Kërcënimi fizik*

Tenisti nuk guxon që ta kërcënojë gjyqtarin, kundërshtarin, shikuesit apo cilindo person tjetër në fushë apo rreth saj. Si kërcënim fizik vlerësohet secila prekje e paautorizuar e gjyqtarit, kundërshtarit, shikuesit apo cilindo person tjetër.

k) *Marrja e këshillave*

Tenisti nuk guxon të merr këshilla gjatë kohës së takimit. Sipas rregullave të tenisit: gjatë takimeve ekipore tenisti mund të merr këshilla nga kapiteni i ekipit i cili qëndron në vendin e caktuar gjatë kohës së ndërrimit të anëve në fund të gemit, por jo edhe në tie-break.

Tenisti që e thyen rregullat e lartpërmendura mund të dënohen nga gjyqtari i karriges ose Mbikëqyrësi.

- 26.6. Për dënimet e dhëna për shkelje të rregullave të sjelljes gjatë të gjithë garave zyrtare të Federatës, ndahen pikët e dënimeve. Dënimet e shqiptuara në bazë të raportit të Mbikëqyrësit i regjistron Komisari. Pikët e dënimeve të cilat jepen për shkeljen e caktuar:

DËNIMET	PIKË
Mosardhja në turne pa paralajmërim	2
Diskualifikim për veshje apo pajisje të parregullt	1
Diskualifikim për lëshim të fushës pa leje	2
Diskualifikim për lëshim të takimit pa arsye	3
Diskualifikim me sistemin e dënimeve shkallë-shkallë	3
Diskualifikim për kërcënim gojor	3
Diskualifikim për kërcënim fizik	5
Diskualifikimet tjera	2

- 26.7. Tenisti që i mbledh 10 pikë dënimi suspendohet nga kalendari i garave të Federatës në periudhë prej 3 muajsh. Komisari e lajmëron tenistin dhe klubin e tij për suspendimin. Vendimi është final dhe tenisti nuk ka të drejtë ankese.
- 26.8. Pikët e dënimit fshihen pas një viti nga dita e përfundimit të turneut në të cilin ka ndodhur shkelja.



II Dispozitat përfundimtare dhe të tjera

27.1. Kjo Rregullore shfuqizon:

- (a) Rregulloren për “Turne individuale” të dt 12 janar 2012;
- (b) Rregulloren për “Kampionat ekipor në tenis” të dt 14 janar 2012;
- (c) Rregulloren “Disciplinore” të dt 14 janar 2012;
- (d) Rregulloren për “Tenisin deri në 10 vjeç – Tenisi i kuq, portokall dhe gjelbër” i dt 12 janar 2013;
- (e) Rregulloren për “Sistemin e poentimit për vitin 2015” të vitit 2015;
- (f) Rregulloren për “Moshën e lejuar për pjesëmarrje në turne për vitin 2017” të vitit 2017;
- (g) Rregulloren “Masters” të vitit 2019; dhe
- (h) Rregulloren për “Mini-Tennis” të vitit 2019.

27.2. Interpretimi përfundimtar i kësaj Rregulloreje është kompetencë e Bordit.

27.3. Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Jeton Hadërgjonaj

Kryetar

Federata e Tenisit e Kosovës

Prishtinë, 17.11.2022

